

Data 03/09 /2025

PROCESVERBAL – TIPI KONTRATËS – SHËRBIME
(PROCEDURË E HAPUR, MBI KUFIRIN E LARTË MONETAR)
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: "RIPARIM, MIRËMBAJTJE E AUTOMJETEVE TË KESH SH.A".

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Riparime, mirëmbajtje dhe shërbime të lidhura me automjete dhe pajisje të lidhura- 50100000-6.

VLERA E FONDIT LIMIT: 41,700,150 (Dyzet e një milion e shtatëqind mijë e njëqind e pesëdhjetë) Lek pa TVSH ose 427,693(katërqind e njëzëet e shtatëmijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre) Euro pa TVSH.

Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, **shumatorja e çmimeve për njësi është :** 232,138,230 (Dyqind e tridhjetë e dy milion e njëqind e tridhjetë e tetë mijë e dyqind e tridhjetë) Lekë pa TVSH ose 2,380,904 (dymilion e treqind e tetëdhjetëmijë e nëntëqind e katër) Euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqiperise në datë 03/09/2025 është 97.50 Lekë/Euro.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor Korporata Elektroenergjitike Shqiptare, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi:

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar. Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar citohet: “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP i ndryshuar “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale : me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës Nr. 10.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përllogaritur të kontratës.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43 pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Duke marrë në konsideratë specifikën e objektit procedurë prokurimi, kërkohet që Operatorët Ekonomik ofertues të paraqesin vërtetime të cilat vërtetojnë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të realizuar këtë procedurë prokurimi në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39 % vlerës së përllogaritur të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të punësuar për periudhën Qershor 2025 - Gusht 2025 jo më pak se 13 (trembëdhjetë) punonjës, nga të cilët në stafin teknik të ketë të paktën:

- 2 (dy) inxhinier mekanik;
- 2 (dy) motorristë;
- 1 (një) pompist;
- 1 (një) saldator;
- 1 (një) gomist;
- 4 (katër) xhenerikë;
- 2 (dy) elektroaut;

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklarimit sipas shtojcës Nr. 10 dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:

-Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Qershor 2025 - Gusht 2025.

-Për inxhinierët, Diplomën dhe kontratën e punës konform akteve ligjore.

-Për personelin tjetër teknik të lartpërmendur, Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë certifikatat/dëshmitë e profesioneve që ushtrojnë, si dhe kontratat e punës respektive konform akteve ligjore.

Argumentimi:

Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Referuar natyrës së shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic janë riparime dhe mirëmbajtje të agregatit të motorrit, të karrocerisë, të sistemeve të drejtimit, frenimit, kondicionimit, amortizimit etj është i nevojshme disponimi i një stafi teknik me profesione si Motorristë, gomist, xhenerikë, elektroaut etj . Ky numër është kërkuar duke u bazuar ne numrin e automjeteve të AK që kanë nevojë për kryerjen e shërbimeve, si dhe natyrën dhe numrin e shërbimeve që kërkohen.

Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se disponon minimalisht 1 (një) bojaxhi, i cili mund të jetë pjesë e stafit të operatorit ekonomik ose i kontraktuar me anë të një marrëveshjeje.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

- ✚ Kontratë pune të vlefshme / kontratë marrëveshjeje bashkëpunimi të vlefshme, e cila të ketë një afat jo më pak se afati i marrëveshjes kuadër;
- ✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Qershor 2025 – Gusht 2025 në rastin nëse bojaxhiu do të jetë pjesë e stafit të operatorit ekonomik;

Argumentimi:

Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se disponojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Referuar natyrës së shërbimeve që kërkohen të prokurohet edhe ljerja e mjeteve, është i nevojshme disponimi i minimalisht 1 (një) bojaxhiu i cili mund të jetë pjesë e stafit të OE por mund të jetë i kontraktuar me kontratë marrëveshjeje bashkëpunimi të vlefshme, e cila të ketë një afat jo më pak se afati i marrëveshjes kuadër. Kjo kërkesë lidhet ngushtë me kërkesën mbi disponon e repart të bojatisjes se mjetit i cili mund të jetë në pronësi, me qera, me huapërdorje ose kontratë shërbimi.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin e prodhuesit/ve ose distributoreve të autorizuar për të gjithë artikujt/mallrat objekt i këtij prokurimi.

Autorizimi duhet të përmbaje të dhëna të plota të prodhuesit/ve distributorëve si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e autorizimeve të prodhuesve ose distributorëve është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave na garanton se Operatori ekonomik ofertues është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të pjesëve/mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Certifikatat ISO ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- a) ISO 9001 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;
- b) ISO 14001 “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”;
- c) ISO 45001 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”;

Argumentimi:

Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenit 44, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe Ligjit Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se këto Certifikata duhet të jenë të lëshuara nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate.

ISO 9001 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” - Ky standard është i nevojshëm për certifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse mallrat e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

ISO 14001 “Sistemi i menaxhimit të mjedisit” - është e nevojshme që Kontraktori të ketë staf të vetëdijshëm për politikën mjedisore dhe pasojat e mundshme të aktiviteteve të tyre në mjedis. Aktivitetet e Kontraktorit duhet të jenë të tilla që të kontrollohet ndikimi në mjedis dhe të përgjigjet në rast emergjence të ndikimit në mjedis.

ISO 45001 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” - është i nevojshëm për ndërgjegjësimin e gjithë personelit të shoqërisë në lidhje me masat e mbrojtjes së shëndetit, sigurisë dhe konsultimit të punësuarve për vlerësimin e rrisqeve të shëndetit dhe sigurisë në punë.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë që pjesët e këmbimit që do të përdorën gjatë riparimit të mjeteve (mallrat e furnizuara) janë të reja dhe të pa përdoruara.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, me anë të këtyre deklaratave AK krijon bindjen se operatori ekonomik ofertues do të përmbush kontratën bazuar në specifikimet dhe kërkesat teknike të kërkuara nga AK, duke garantuar furnizim me mallra të reja dhe të papërdorura.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencën VII.3.B.1 “Riparimi dhe mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për pikat a, b, c, ç, sipas udhëzimit Nr.1546 datë 29.03.2016: “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar, nenit 41, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku citohet:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Disponimi i Licencës VII.3.B.1 dhe pikat a,b,c,ç është kërkuar në përputhje me udhëzimin Nr.1546 datë 29.03.2016 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, ku Neni 1 citon se :

Subjektet juridike, për të marrë licencë për veprimtaritë "Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove", me kodin VII.3.B.1/a, b, c, ç, d, dh, në Qendrën Kombëtare të Licencimit (QKL), në juridiksionin e të cilit është selia e subjektit, dhe për të ushtruar veprimtaritë e autoriparimit, në një ose në disa nga specifikimet e përcaktuara në të, duhet të disponojnë pajisjet, instrumentat, ambientet e nevojshme, si dhe të plotësojnë kushtet dhe procedurat, respektivisht, sipas nenit ose neneve përkatëse të këtij udhëzimi.

Në zbatim të nenit 2, 3, 4 dhe 5 të udhëzimit Nr.1546 datë 29.03.2016 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, pikat a, b, c, ç janë kërkuar në bazë të ushtrimit të veprimtarisë së riparimit dhe të mirëmbajtjes konkretisht :

- VII.3.B.1/a Riparimi dhe mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.
- VII.3.B.1/b Riparimi dhe mirëmbajtja e karrocërisë, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.
- VII.3.B.1/c Riparimi dhe mirëmbajtja e impiantit elektrik, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.
- VII.3.B.1/ç Riparimi dhe mirëmbajtja e gomave, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues (në lidhje me repartin e bojtisjes së mjeteve) duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të tipit B, Kodi III.1.B, lëshuar nga QKL.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar, nenit 41, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku citohet:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Gjithashtu, Leja mjedisore të tipit B, Kodi III.1.B, lëshuar nga QKL, është kërkuar në përputhje me Ligjin nr.10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit, i ndryshuar”.

Në nenin 3 pika 13 të tij parashikohet: 13. “Leje mjedisi e tipit B” është leja e përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe e firmosur nga ministri, e cila lëshohet nga QKL-ja, që i jep të drejtën e funksionimit, tërësisht ose pjesërisht, instalimit të tipit B, sipas përcaktimit të këtij ligji dhe që përmban të shkruara kushtet e nevojshme për të garantuar se instalimi përmbush kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi. Një leje mund të mbulojë një ose më shumë instalime ose pjesë të instalimeve në të njëjtën vendndodhje dhe që operohen nga një i njëjti operator.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të vërtetojë se disponon ambientet për ushtrimin e aktivitet të tij lidhur me riparimin e automjeteve, në zonat ku ndodhen njësitë përkatëse të AK KESH sha : Tiranë, Shkodër, Tropojë.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklarimit sipas shtojcës Nr. 10 dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri duhet të paraqesin:

- Dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje/ kontrata huapërdorje/çdo dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).
- Në rast se objekti është me qira apo në përdorim të paraqitet kontrata e vlefshme, e cila të ketë një afat jo më pak se afati i marrëveshjes kuadër.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion ambientin, mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se shërbimi që ofrohet objekt i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, të cilat duhet të dërgohen në ambientet e servisit të përcaktuar nga AK është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë që kanë në pronësi ose me qira në përdorim të ambienteve për ushtrimin të aktivitet të tij (lidhur me riparimin e automjeteve) në të gjitha zonat ku ndodhen njësitë përkatëse të AK KESH sha: Tiranë, Shkodër, Tropojë.

Disponimi i ambienteve , lidhet ngushtësisht me objektin e prokurimit, duke krijuar siguri dhe garanci për AK që ofertuesi ka kapacitetet e domosdoshme për të përmbushur me sukses kontratën, në kohë dhe konform specifikimeve teknike të kërkuara.

2.3.10 Operatori ekonomik ofertues në lidhje me Agregatet / Pajisjet / Pjesët e këmbimit që do të përdoren gjatë realizimit të shërbimeve, duhet të paraqesë deklaratë se janë të certifikuara me certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ekuivalent.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion Agregatet / Pajisjet / Pjesët e këmbimit të certifikuara sipas standardeve kombëtare/ndërkombëtare për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.11 Operatori ekonomik ofertues duhet të krijojë dhe paraqesë tabelën teknike, referuar pjesëve të këmbimit të kërkuara në specifikimet teknike të DT-ve. Tabela duhet të përmbajnë për të gjithë zërat e pjesëve të këmbimit, Emrin e kompanisë prodhuese, Emërtimin e katalogut të artikullit/ produktit, si dhe kodin origjinal

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar, si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

2.3.12 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon minimalisht pajisjet e nevojshme për realizimin e kontratës, si vijon:

- 4 (katër) ura ngritëse për automjetet (me kapacitet jo me pak se 3 Ton);
- 3 (tre) ura ngritëse për furgonat (me krah të gjatë) me kapacitet jo me pak se 4 Ton;
- 2 (dy) gropa për mjetet e renda (kamiona, autovinça, fadroma);
- 1 (një) pajisje diagnostikuese të defektit në automjet;
- 1 (një) pajisje për kontrollin dhe testimin e sistemit frenimit të automjetit;
- 1 (një) pajisje për kontrollin dhe testimin e sistemit të amortizimit të automjetit;
- 1 (një) pajisje për kontrollin dhe testimin e defekteve (xhokove) në sistemin e drejtimit;
- 1 (një) pajisje të lëvizshme për ndezje emergjente të mjetit 12 v dhe 24 v;
- 1 (një) pajisje bango prove për motorrinë dhe dinamo;
- 1 (një) pajisje për rregullimin e ndriçimit të automjeteve;
- 1 (një) pajisje për saldim me oksigjen dhe acetilen;
- 1 (një) pajisje për saldim me argon;
- 1 (një) pajisje për saldim me elektrik;
- 1 (një) pajisje për kontrollin dhe komprimimin e gazit të A/C;
- 1 (një) pajisje për sistemin e kontrollit dhe dedektimin të rrjedhjes së sistemit të ftohjes të automjetit (Radiatori dhe Pjesëve përbërëse të tij);
- 1 (një) pajisje për kontrollin dhe realizimin e gjeometrisë (konvergjencës) rrotave të mjetit të kompletuara përkatësisht me urat me katër kollona të përshtatshme në kapacitet për fuoristradat dhe furgona;
- 1 (një) pajisje për zmontimin dhe montimin e gomave në diskun e rrotës së automjetit;
- 1 (një) pajisje për kontrollin dhe balancimin e disqeve dhe gomave të automjetit (ballancimi rrotave);
- Të ketë repart të riparimit karrocërisë së automjetit (shasisë, tapicerisë dhe përpunimit të llamarinës) si dhe 1 (një) pajisje për drejtim shasie të cilat të kenë kapacitet në përshtatje të plotë me mjetet për realizimin e shërbimeve, sikurse kërkohet përkatësisht në specifikimet teknike

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklarimit sipas shtojcës Nr. 10 dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:

- Dokumentacion për mjetin në pronësi, ose me qira, ose me huapërdorje (fatura blerje/dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje /kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, të cilat duhet të realizohen sipas specifikimeve teknike, ku një pjesë e tyre mund të ofrohet nga OE duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht ambientin e prodhimit, makineritë, pajisjet, asetet e nevojshme të përcaktuara më sipër si dhe kapacitetet njerëzore, stafin e nevojshëm dhe kualifikimet profesionale me qëllim realizimin me sukses të shërbimeve për një periudhë 1 (një) vjeçare.

2.3.13 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon minimalisht repart të bojatisjes se mjetit te pajisur me : 1 (një) furrë për lyerje, repartin për përgatitjen paraprake për bojatisje të kompletuar me pajisjet përkatesë (pajisje spoter për drejtim llamarinë, puntatrice, aparat saldimi, stukim, pajisje zmerilimi, lucidim etj).

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklarimit sipas shtojcës Nr. 10 dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:

- Dokumentacion për mjetin në pronësi, me qera, me huapërdorje ose kontratë shërbimi, (fatura blerje/dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje /kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / kontratë shërbimi, çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion repart bojatisje për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.14 Operatori ekonomik ofertues duhet të vërtetojë se disponon minimalisht 2 (dy) Karroatrec për transportimin e automjeteve të difektuara.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklarimit sipas shtojcës Nr. 10 dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:

- Dokumentacion për mjetin në pronësi, ose me qira, ose me huapërdorje (fatura blerje/dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).
- Leja e qarkullimit të mjetit, Akt – kolaudimi, Polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate është riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve, ndër të cilat mund të ndodh që kërkohet transporti i një automjet të difektuar në ambientet e servisit që disponon OE, është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht 2 (dy) Karroatrec për transportimin e automjeteve të difektuara.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

- Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, konkretisht KESH sh.a dhe Njësitë të Prodhimit HEC Fierzë, HEC Koman dhe HEC Vau i Dejës, sipas parashikimeve të nenit të 36, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.
- Specifikimet teknike janë hartuar të detajuara, pasi kategorizohet tek shpenzimet operative të domosdoshme, pasi lidhet me mbarëvajtjen e punës së kompanisë dhe sigurinë e shëndetit dhe jetës së punonjësve të cilët udhëtojnë me këto mjete që kanë nevojë për riparim, të cilat përshkruajë të dhënat teknike të çdo mjeti si dhe riparimet të parashikuara për çdo automjet, të grupuara sipas tipit të mjeteve me zëra dhe sasi.

Njësia e Prokurimit